

Vendim nr. 238 datë 24.09.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Marjana Semini,	Anëtare
Ilir Toska,	Anëtar

në datën 24.09.2025 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 11 (L) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **LULZIM LILA**, përfaqësuar nga avokat Ervis Lila, sipas prokurës së posaçme.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 10-2015-918 (421), datë 29.04.2015 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2025-824, datë 05.03.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, 49, 52, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi i është drejtuar gjykatës me një kërkesë, bazuar në nenin 388 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), për njohjen e vjetërsisë në punë si nënoficer në Komisaratin e Policisë Gramsh, për periudhën 14.11.1992 - 08.04.1998, me pretendimin se dokumentacioni i vjetërsisë në punë i këtij komisarati për të gjithë punonjësit e tij është djegur në trazirat e marsit të vitit 1997, ndërkohë që nga vërtetimi i faktit të vjetërsisë në punë për periudhën e pretenduar për të varej lindja e së drejtës së përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, sipas kriterëve të përcaktuara në legjislacionin përkatës.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 579 (13-2013-1506), datë 19.03.2013, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe vërtetimin e faktit juridik të qenies së kërkuesit në marrëdhënie pune, si polic, në Komisaratin e Policisë Gramsh për periudhën 14.11.1992 - 15.03.1997. Ajo gjykatë, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar se provohet kushti i kërkuar nga neni 388, paragrafi 1, i KPC-së, për vërtetimin gjyqësor të faktit të vjetërsisë në punë të kërkuesit për periudhën e pretenduar dhe se ky fakt u provua nga prova me dëshmitarë, por edhe nga dokumentacioni përkatës për vjetërsinë e tij në punë për periudhën e mëvonshme 16.03.1997 - 08.04.1998. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim personi i tretë, Drejtorja e Policisë së Qarkut Elbasan.

3. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2015-918 (421), datë 29.04.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e kërkesës së kërkuesit. Gjykata e apelit, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar se gjykata e shkallës së parë ka gabuar në zbatimin e nenit 388, paragrafi 1, të KPC-së, pasi në rastin konkret nuk plotësohet kushti i kërkuar nga kjo dispozitë për vërtetimin gjyqësor të faktit juridik të vjetërsisë në punë të kërkuesit, pasi vërtet dokumentacioni i vjetërsisë në punë i Komisaratis të Policisë Gramsh është djegur, por të dhënat e vjetërsisë në punë për të gjithë punonjësit e Policisë së Shtetit ruhen edhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, ndërsa kjo e fundit, me shkresën nr. 494/3-2 prot., datë 23.04.2015, ka konfirmuar se nga verifikimet e kryera në kartotekën e personelit, kërkuesi nuk figuron i evidentuar si punonjës në strukturat e Policisë së Shtetit për periudhën e kërkuar. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi.

4. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2025-824, datë 05.03.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se ai nuk përmban asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 472 të KPC-së.

5. Në datën 07.07.2025, përmes shërbimit postar, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, i cili është regjistruar në datën 09.07.2025.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, më mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, në drejtim të:

- 6.1. *Parimit të disponibilitetit*, pasi Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje shteruese të gjitha pretendimeve në rekursin e kërkuesit, duke mos vepruar ajo si një mjet efektiv.
- 6.2. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi, sipas tij, Gjykata e Lartë duhet ta kishte shqyrtuar çështjen në përputhje me ligjin, duke qenë se me ndryshimet e bëra KPC-së mund ta zgjidhte vetë çështjen ose t'ia kthente gjykatës së apelit, duke i përcaktuar edhe detyrat përkatëse.
- 6.3. *Së drejtës për t'u njoftuar*, pasi gjykimi në Gjykatën e Lartë është zhvilluar pa u njoftuar kërkuesi, duke mos iu dhënë atij mundësia për të parashtruar pretendimet e tij në lidhje me çështjet e ngritura për diskutim në atë gjykatë.
- 6.4. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykata e apelit pas riçeljes së hetimit gjyqësor, ndonëse ka marrë të njëjtën provë që ishte administruar edhe në gjykimin në shkallë të parë, duke mos i vlerësuar dëshmitë e dëshmitarëve, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuesit. Ajo gjykatë nuk ka arsyetuar se pse ishte e rëndësishme në vendimmarrje ajo provë, duke mos përmbushur vendimi i saj standardet kushtetuese.
- 6.5. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka zbatuar ligjin procedural dhe i ka vendosur palët në kushtet e pasigurisë juridike. Në zbatim të nenit 473/a të KPC-së, në momentin e konstatimit se gjykata e apelit nuk kishte arsyetuar vendimin, ajo duhet ta korrigjonte kryesisht shkeljen, duke qenë se edhe vetë kërkuesi ka pretenduar në rekurs se gjykata e apelit ka vlerësuar në mënyrë të njëanshme provën e marrë pas riçeljes së hetimit gjyqësor.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

7. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Në këtë këndvështrim, kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, ndaj për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

9. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

10. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 05.03.2025, i cili sipas komunikimit elektronik të asaj gjykate është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 09.04.2025, ndërkohë që kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 07.07.2025 (sipas shënimit të shërbimit postar), pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

11. Lidhur me legjitimitimin *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar se është cenuar parimi i disponibilitetit, e drejta për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, e drejta për t’u njoftuar, standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe parimi i sigurisë juridike.

12. Lidhur me pretendimin e cenimit të së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, sipas kërkesit, Gjykata e Lartë duhet ta kishte shqyrtuar çështjen në përputhje me ligjin, duke qenë se me ndryshimet e bëra KPC-së mund ta zgjidhte vetë çështjen ose t’ia kthente gjykatës së apelit, duke i përcaktuar edhe detyrat përkatëse.

13. Kolegji vëren se sipas nenin 485, pika 1, shkronja “a”, të KPC-së, pas shqyrtimit të çështjes, Gjykata e Lartë vendos mospranimin e rekursit në rastet kur është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikon neni 472 i këtij kodi. Referuar rastit konkret, Kolegji konstaton se Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, me arsyetimin se ai nuk përmban asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 472 i KPC-së. Për rrjedhojë, Kolegji vëren se Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me legjislacionin procedural civil. Nisur nga kjo, argumenti i sjell nga kërkuesi nuk mbështet pretendimin e tij për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, ndaj ai nuk mund të merret në shqyrtim.

14. Në lidhje me pretendimin për cenimin e *së drejtës për t’u njoftuar*, sipas kërkuesit, gjykimi në Gjykatën e Lartë është zhvilluar pa u njoftuar ai, duke mos iu dhënë mundësia për të parashtruar pretendimet e tij në lidhje me çështjet e ngritura për diskutim në atë gjykatë.

15. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për t’u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 8, datë 23.02.2021; nr. 49, datë 22.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në lidhje me procedurat e rekursit, Kolegji vëren se neni 480 i KPC-së parashikon shqyrtimin e tij në lidhje me kushtet e pranueshmërisë në dhomën e këshillimit. Më tej, në rastin kur rekursi plotëson kushtet e pranueshmërisë, çështja shqyrtohet në seancë gjyqësore, si rregull, në dhomën e këshillimit mbi bazë dokumentesh (neni 482 i KPC-së) ose në prani të palëve (neni 482/a i KPC-së). Për këtë shqyrtim palët njoftohen për ditën, orën dhe përbërjen e trupit gjykues, të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit, përmes shpalljes në ambientet e Gjykatës së Lartë, si dhe në faqen e saj të internetit dhe me njoftim individual kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjyqimit.

17. Në rastin në shqyrtim, Kolegji konstaton se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje mbi bazën e rekursit të kërkuesit. Rekursi është shqyrtuar në dhomën e këshillimit të datës 05.03.2025. Njoftimi për shqyrtimin e çështjes është publikuar në datën 18.02.2025 në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë. Në datën e planifikuar (05.03.2025), Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka shqyrtuar rekursin, duke vendosur mospranimin e tij, mbështetur në nenin 480 të KPC-së. Kolegji vëren se rekursi i kërkuesit i është nënshtruar shqyrtimit paraprak të pranueshmërisë, shqyrtim ky që lidhet me verifikimin e kushteve formale të paraqitjes së tij dhe të ekzistencës së shkaqeve të lejuara nga ligji, qoftë në aspektin formal, ashtu edhe në atë

substancial, duke u mbështetur në aktet e dosjes gjyqësore. Po ashtu, ndonëse ligji procedural nuk parashikon shprehimisht njoftimin e palëve për shqyrtimin paraprak të rekursit, në rastin konkret ato janë njoftuar në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji. Në kontekst të rrethanave të rastit konkret, Kolegji vlerëson se kërkuesi ka ushtruar lirisht të drejtën e ankimit në një gjykatë më të lartë, të rekursit në këtë rast, ndërkohë që për sa i përket cenimit të pretenduar të së drejtës për t'u njoftuar nga Gjykata e Lartë, ai nuk ka parashtruar argumente të mjaftueshme për të treguar sesi ajo mënyrë njoftimi nga ana e asaj gjykate ka passjellë cenimin e ndonjë të drejte procedurale të lidhur dhe të ndërruar prej saj. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuesit nuk mund të merret në shqyrtim.

18. Për sa i përket pretendimit për cenimin e *parimit të sigurisë juridike*, sipas kërkuesit Gjykata e Lartë nuk ka zbatuar ligjin procedural dhe i ka vendosur palët në kushtet e pasigurisë juridike. Sipas tij, në zbatim të nenit 473/a të KPC-së, në momentin e konstatimit se gjykata e apelit nuk kishte arsyetuar vendimin, ajo duhet ta korrigjonte kryesisht shkeljen, duke qenë se edhe vetë ai (kërkuesi) ka pretenduar në rekurs se gjykata e apelit ka vlerësuar në mënyrë të njëanshme provën e marrë pas riçeljes së hetimit gjyqësor.

19. Në rastin konkret, Kolegji vëren se argumentet e kërkuesit për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike, duke iu referuar nenit 473/a të KPC-së, në thelb, duket se kanë të bëjnë me të drejtën e aksesit. Megjithatë, Gjykata e Lartë në këtë rast nuk ka vënë në diskutim kryesisht ndonjë çështje të ligjit, për të cilën palët nuk kanë paraqitur më parë mendimin e tyre, sikurse parashikon dispozita e referuar nga kërkuesi, ndaj ky pretendim për këtë argument nuk mund të merret në shqyrtim.

20. Kolegji vëren po ashtu se për këtë pretendim kërkuesi ka parashtruar si argument edhe se Gjykata e Lartë ka konstatuar mungesë të arsyetimit të vendimit nga gjykatat e apelit, shkelje të cilën duhet ta korrigjonte vetë, për sa kohë ai (kërkuesi) në rekurs ka pretenduar se gjykata e apelit ka vlerësuar në mënyrë të njëanshme provën e marrë pas riçeljes së hetimit gjyqësor. Nisur nga thelbi i këtij argumenti, pretendimi i kërkuesit duket se ka të bëjë me mungesën e arsyetimit të vendimit nga gjykata e apelit, sikundër edhe me përgjigjen që Gjykata e Lartë i ka dhënë pretendimit të tij në rekurs për vlerësimin e provave dhe interpretimin e ligjit procedural nga gjykata e apelit, ndaj ky pretendim për këtë argument do të analizohet në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

21. Ndërsa për sa i përket pretendimit të cenimit të *parimit të disponibilitetit*, sipas kërkuesit, Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje shteruese të gjitha pretendimeve në rekurs, duke mos vepruar ajo si një mjet efektiv. Në lidhje me këtë pretendim, edhe pse ai është ngritur në drejtim të parimit të disponibilitetit, Kolegji vëren se, në thelb, argumentet e kërkuesit në

mbështetje të këtij pretendimi kanë të bëjnë me të drejtën e aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, ndaj do të analizohen në këtë drejtim.

22. Për sa më lart, Kolegji në vijim do të analizojë pretendimin e kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, i cili *prima facie* bën pjesë në juridiksionin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

23. Kërkuari ka pretenduar se gjykata e apelit pas riçeljes së hetimit gjyqësor, ndonëse ka marrë të njëjtën provë që ishte administruar edhe në gjykimin në shkallë të parë, duke mos vlerësuar dëshmitë e dëshmitarëve, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së tij. Megjithatë, ajo gjykatë nuk ka arsyetuar se pse ishte e rëndësishme në vendimmarrje kjo provë. Edhe Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje shteruese të gjitha pretendimeve në rekurs. Ajo, megjithëse ka konstatuar mungesë të arsytimit të vendimit nga gjykatat e apelit, nuk e ka korrigjuar shkeljen e saj, ndonëse në rekurs kërkuari ka pretenduar se gjykata e apelit ka vlerësuar në mënyrë të njëanshme provën e marrë pas riçeljes së hetimit gjyqësor.

24. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 6, datë 22.02.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në lidhje me arsyetimin e vendimeve gjyqësore, Gjykata është shprehur se ai është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre, në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit. Ato, gjithashtu, duhet të jenë të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese të tij (*shih vendimet nr. 79, datë 14.12.2017; nr. 63, datë 23.09.2015; nr. 3, datë 26.01.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Në lidhje me vendimet e Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit, Gjykata ka pohuar se ato mund të arsyetohen në

mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015; nr. 37, datë 19.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Po kështu, Gjykata në mënyrë konstante ka pohuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 64, datë 01.10.2024; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, Kolegji vëren se me pretendimin se nuk ekziston dokumentacioni i vjetërsisë në punë në Komisariatit e Policisë Gramsh, për periudhën 14.11.1992 - 15.03.1997, për shkak të djegies së tij gjatë trazirave të vitit 1997, ndërkohë që nga vërtetimi i faktit të vjetërsisë në punë për atë varej lindja e së drejtës së përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, kërkuesi ka kërkuar nga gjykata vërtetimin gjyqësor të këtij fakti bazuar në nenin 388, paragrafi 1, të KPC-së, sipas të cilit kur nga një fakt varet lindja, ndryshimi ose shuarja e të drejtave personale apo pasurore të një personi dhe akti që vërteton atë është zhdukur, ka humbur dhe nuk mund të bëhet përsëri ose nuk mund të merret me ndonjë rrugë tjetër, personi i interesuar ka të drejtë të kërkojë që fakti të vërtetohet me vendim të gjykatës së shkallës së parë.

28. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur pranimin e kërkesës, duke vërtetuar faktin juridik të vjetërsisë në punë të kërkuesit, si polic, në Komisariatit e Policisë Gramsh, për periudhën 14.11.1992 - 15.03.1997. Ajo gjykatë ka vlerësuar se kërkuesi ka interes të ligjshëm për paraqitjen e kërkesës, e cila, nga ana tjetër, është e bazuar në prova dhe ligj. Sipas saj, provohet kushti i kërkuar nga ligji, neni 388, paragrafi 1, i KPC-së, për vërtetimin gjyqësor të faktit juridik të vjetërsisë në punë të kërkuesit për periudhën e pretenduar, pikërisht zhdukja, djegia e dokumentacionit të vjetërsisë në punë të Komisariatit të Policisë Gramsh. Po ashtu, nga prova me dëshmitarë provohet fakti se kërkuesi ka punuar në atë komisarati për periudhën nëntor 1992 - prill 1998, përveçse ky fakt provohet edhe nga dokumentacioni përkatës për

periudhën 16.03.1997 - 08.04.1998, i cili shërben si provë edhe për sa i përket faktit se kërkuesi ka punuar edhe para datës 16.03.1997.

29. Çështja në vijim është shqyrtuar nga gjykata e apelit mbi ankimin e personit të tretë, Drejtorisë së Policisë së Qarkut Elbasan. Ajo gjykata ka çmuar të përsërisë pjesërisht hetimin gjyqësor dhe të kërkojë informacion për vjetërsinë në punë të kërkuesit nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore. Pas administrimit të përgjigjes nga kjo e fundit, gjykata e apelit ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuesit. Gjukata e apelit ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë ka gabuar në zbatimin e nenit 388, paragrafi 1, të KPC-së, pasi në rastin konkret nuk plotësohen kushtet e kërkuara nga kjo dispozitë për vërtetimin gjyqësor të faktit juridik të vjetërsisë në punë të kërkuesit. Sipas saj, ndonëse provohet se dokumentacioni i vjetërsisë në punë në Komisariatën e Policisë Gramsh është djegur, të dhënat e vjetërsisë në punë për të gjithë punonjësit e Policisë së Shtetit ruhen edhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, e cila, me shkresën nr. 494/3-2 prot., datë 23.04.2015, ka konfirmuar se nga verifikimet e kryera në kartotekën e personelit, kërkuesi nuk figuron i evidentuar si punonjës në strukturat e Policisë së Shtetit për periudhën e kërkuar. Po sipas saj, kërkuesi nuk ka arritur të provojë faktin e pretenduar të vjetërsisë në punë në Komisariatën e Policisë Gramsh për periudhën e pretenduar.

30. Çështja i është nënshtruar kontrollit edhe nga Gjykata e Lartë, e cila ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se ai nuk përmban asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 472 të KPC-së. Sipas Gjykatës së Lartë, nga ana e gjykatës së apelit janë respektuar normat procedurale, të cilat mund të çojnë në pavlefshmërinë e vendimit gjyqësor ose të procedurës së gjykimit, ndërkohë që nuk rezulton të ketë shkelje të rënda procedurale, të cilat të kenë ndikuar dukshëm në dhënien e vendimit nga ajo. Po sipas saj, gjatë gjykimit të zhvilluar palëve iu është dhënë mundësia të realizojnë të drejtën e tyre të mbrojtjes, të paraqesin prova, të njihen me provat e palës kundërshtare, të debatojnë në lidhje me to, të shprehin qëndrimin e tyre për zgjidhjen e mosmarrëveshjes etj., duke u respektuar të gjitha parimet bazë të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor, si dhe gjykata e apelit ka bërë një cilësim të drejtë të fakteve dhe rrethanave që lidhen me mosmarrëveshjen, ka kryer një analizë juridike të plotë të provave dhe e ka zgjidhur mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Së fundi, vendimi i gjykatës së apelit nuk vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Civil ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

31. Referuar standardeve kushtetuese të mësipërme, Kolegji vëren se vendimet gjyqësore objekt kërkesë përmbushin këto standarde. Kërkuesi ka ushtruar lirisht të drejtën për

të parashtruar pretendime për prova dhe për çështje të faktit e të ligjit gjatë gjykimit të çështjes në apel, sikundër edhe për të paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, duke marrë nga ato gjykata përgjigje për pretendimet e tij. Vendimet e kundërshtuara të gjykatave përmbajnë pretendimet e palëve, analizën e provave dhe faktet e pranuar, ligjin e zbatueshëm dhe analizën e tij në kontekst të rrethanave të rastit konkret. Gjykata e apelit, në ushtrimin e funksioneve të saj si gjykatë fakti, ka përsëritur pjesërisht hetimin gjyqësor dhe bazuar në vlerësimin e provës shkresore të administruar në atë shkallë gjykimi, përmes përcaktimit të ndryshëm nga gjykata e shkallës së parë të faktit të ekzistencës së dokumentacionit të vjetërisë në punë të Komisarariatit të Policisë Gramsh, ka mbajtur qëndrim të ndryshëm edhe për sa i përket zbatimit të ligjit procedural në rastin konkret, duke vlerësuar se nuk është në kushtet e kërkuara nga ligji për vërtetimin gjyqësor të faktit juridik të pretenduar nga kërkuesi. Edhe vendimi i Gjykatës së Lartë, ndonëse me arsyetim të kufizuar, tregon vendimmarrjen e gjykatave të faktit, shkaqet e ngritura në rekurs, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku mbështetet qëndrimi i shprehur në dispozitiv. Përmes parashtrimit të shkaqeve të rekursit në vendimin gjyqësor të kundërshtuar, Gjykata e Lartë tregon se pasi i ka vlerësuar ato, ka arritur në përfundimin se rekursi i paraqitur nga kërkuesi është haptazi i pabazuar, pasi shkaqet e ngritura në të nuk gjejnë mbështetje në nenin 472 të KPC-së.

32. Nga ana tjetër, Kolegji vëren se argumentet e paraqitura nga kërkuesi për të drejtat e pretenduara si të cenuara, në thelb, kanë të bëjnë me vlerësimin e provave, përcaktimin e fakteve dhe interpretimin e zbatimit të ligjit nga gjykatat e zakonshme. Në këtë kontekst, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka arritur të argumentojë se përcaktimi i fakteve dhe zbatimi i ligjit nga gjykatat e zakonshme është arbitrar në kuptimin që gabimi faktik ose ligjor i tyre të jetë aq i dukshëm sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që e bën gjykimin të padrejtë. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit, si aspekte të së drejtës për proces të rregullt, është haptazi i pabazuar.

33. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “a”, “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.